



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 09/2024

I Mbajtur në takimin e VIII-të të rregullt të KK-së me datën 27.09.2024, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VIII-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;
4. Propozim – Vendim për Miratimin e Projekt Buxhetit të Komunës së Ferizajt për Vitin 2025;
5. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 1140-2 Z.K. Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 3280-0 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt;
6. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 2039-1 Z.K. Sojevë, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1378-1 Z.K. Sojevë, pronë e Komunës së Ferizajt;
7. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 2037-0 Z.K. Jezerc, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1157-0 Z.K. Nerodime e Ulët, pronë e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 2435-1 dhe 2435-2 Z.K. Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit pjesën e parcelës kadastrale 180-10 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
9. Propozim – Vendim për anulimin e Vendimit 01.Nr.111 të datës 31.08.2022 dhe anulimin e Vendimit 01.Nr. 48 të datës 30.05.2024;
10. Propozim – Vendim për anulimin e Vendimit 01.Nr. 69 të datës 31.07.2024 dhe Anulimin e pjesërisht të Vendimit 01.Nr.09 të datës 03.02.2017;
11. Propozim – Vendim për dhënie të pëlqimit “Stacionit të Autobusëve” SH.A. për dhënie në shfrytëzim të lokaleve afariste;
12. Propozim – Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së parcelës kadastrale 992-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve dhe Objektit- Fabrikës për prodhim të Ujit e ndërtuar në këtë parcelë subjektit juridik - Kompanisë rajonale K.R.U. “Bifurkacioni”;

13. Propozim – Vendim për Këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale ; 784-0,785-0 Z.K. Manastircë, prona private, me pjesët e ngastrave kadastrale 138-0, 130-0 Z.K. Manastircë, prona e Komunës së Ferizajt;
14. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 1199-40, 1199-43,1059-3,1059-6 dhe 1263-0 Z.K. Prelez i Jerlive pronë private;
15. Propozim – Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtës të objekteve të Institucioneve Parashkollë – Çerdheve;
16. Pyetje dhe kërkesa dhe
17. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i falënderoj për pjesëmarrje dhe theksoi se kjo pikë është me theks të veçantë pasi është edhe propozimi i njërit prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës e që është buxheti, dhe lexoi rendin e ditës të lartcekur.

Dhe theksoi që me kërkesë të drejtorit të Arsimit ka një obligim familjar dhe duhet të largohet me herët andaj propozoj që pika e 15 të kaloj në pikën 5.

A ka dikush rreth rendit të ditës:

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se pra kërkesa që dul sot të pikën e 5 duhet të tërhiqet dhe mos të vije asnjëherë këtu privatizimi i çerdheve të cilat objekte janë ndërtuar për tu funksionalizuar andaj kërkoj që fare mos të hy në rend të ditës.

Flamur Istrefi pasi përshëndeti të pranishmit pra pika e 5 edhe unë e mbështes propozimin e kolegut pra duhet të shtyhet dhe mos të vije fare pasi janë shterruar diskutimet dhe me praninë e prindërve dhe edukatoreve sot bëhet edhe më i fortë kjo çështje duhet të diskutohet mirë e mirë e pastaj të vihet këtu.

Hatixhe Bungu pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit edhe unë kërkoj që ky propozim për kopshteve të shtyhet për një seance tjetër për hirë të transparencës dhe llogaridhënies i nderuar kryetar Aliu të gjitha projektet që i ke bërë deri më tani dhe të gjitha vendimet ke qenë transparent nuk e di pse ju ka ikë kjo për çerdhe duhet ta kesh parasysh që zyri i qytetarëve duhet të dëgjohet për këtë temë që është kaq madhore, ju faleminderit.

Kryesuesi pasi spati të tjerë për të diskutua rreth rendit të ditës theksoi se unë e qes në votim rendin e ditës ashtu si e kemi miratua në KPF kush është për?

Dhe konstatoi se me 19 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim kalon rendi i ditës.

Kryesuesi pyeti nëse ka dikush lidhur me pikën 3 ose procesverbalin dhe pasi i pati të gjitha votat për 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 4 dhe ia kaloi fjalën kryetarit të Komunës Agim Aliut.

I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës,

Drejtorë të drejtorive komunale,

Të respektuar anëtarë të Kuvendit,

Shoqëri civile, media,

Zonja dhe zotërinj!

Në agjendën e sotme të punës së Kuvendit të Komunës, kemi në shqyrtim e diskutim, dokumentin themelor të qeverisjes lokale, bazën e cila paraqet pikënisjen e punëve publike dhe dobisë së drejtpërdrejt për qytetarët, Projektbuxhetin për vitin 2025 si dhe projeksionet e hershme për vitet pasuese.

Dokumenti që paraqitet para jush, është një pasqyrë që reflekton kërkesat e qytetarëve, projeksionet zhvillimore e nismat konkrete për Ferizajn që meriton secili ferizajas.

Natyrisht, ky projektbuxhet për vitin 2025, në kufijtë e mundësive të saj, paraqet kulmimin e nevojave më të domosdoshme, zgjidhjeve të duhura, projekteve nga të cilat, buroi e po vijon, vala e pandalshme e transformimit rrënjësor të gjithë qytetit tonë, fshatrave tona, çdo lagje e çdo vendbanimi.

Andaj, në lartësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë para qytetarëve, paraqesim brenda kësaj kornize, dhjetëra projekte, nisma, ide të përkthyer në sipër marrje institucionale, që shumëfishojnë mundësitë, mirëqenien e përparimin e Ferizajt e ferizajasve.

Përtej fjalëve e fjalive në varg, përtej shifrave të çdofaqshme të këtij dokumenti, reflektohet vizioni, energjia, guximi e cilësitë profesionale të qeverisjes sonë, për të garantuar shërbime e punë publike, cilësore e madhore për qytetin e fshatrat tona.

Zonja dhe zotërinj!

Ferizajasve edhe sot, përmes kësaj ngrehine financiare vjetore, përmes projektbuxhetit të vitit 2025, i themi se PO: kemi edhe shumë ide, shumë nisma, pashterrshëm energji për ta bërë edhe më të begatë Ferizajn tonë.

Janë mbi 100 projekte të rëndësisë kapitale, ato që përbëjnë faqet e këtij volumi para jush sot, të cilat të shtrira në kohë e në përlllogaritje financiare, janë garancia e një Ferizaj krejt të sigurt, të palëkundshëm e të pandalshëm, në rrugën që kemi nisur për transformimin e madh e të shumanshëm.

Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2025, arrin lartësinë në vlerën totale 46,013,006.00€ e që ndarë vetëm në fushën e investimeve kapitale kemi 12,328,834.32€ për projektet kapitale të Komunës së Ferizajt për vitin kalendarik 2025.

Përtej një akti formal, vendimmarrja për projektbuxhetin e vitit 2025, vesh me përgjegjësi dhe vendos në kalendarin e punëve publike, prioritetet e qytetarëve në 365 ditët e ardhshme.

Në kushte të tilla të vendimmarrjes së drejtpërdrejt për interesin e qytetarëve, jam besimplotë në autorizimin ligjor që do të marr nga ju, ky dokument sot.

Me kujdesin më të plotë për shpenzimin e parasë publike, me qasje gjithëpërfshirëse, duke u shërbyer me analizë e konsultë publike, në këtë projektbuxhet, gjen veten secila kategori e shoqërisë, secili komunitet në secilën lagje e fshat përgjatë gjithë territorit tonë.

Në këtë mandat qeverisës, fokusi i skuadrës sonë qeverisëse, është përqëndruar në projekte të gjelbërta, duke ndërmarr nisma transformuese, projekte që i japin dimension të ri hapësirave publike në Ferizaj, si pjesë e planeve investuese të Komunës së Ferizajt.

Janë pikërisht projektet si zgjerimi dhe rregullimi i Parkut “Liria”, një masivi të gjelbër të jashtëzakonshëm, po kështu edhe rregullimi i Parkut në Kodrën e Sherretëve që tashmë ka marr formë e po jetësohet dita-ditës, ato që i japin mijëra metra hapësirë të re publike, të gjelbër, bashkëqytetarëve tonë.....

.....pa lënë anash edhe projektin për rregullimin e parkut tek lokacioni ku aktualisht ndodhet Kompania “Pastërtia” me të cilat Ferizajt i shtohen 3 kurora masive të gjelbërta brenda dhe skaj qendrës së qytetit.

Qeverisja jonë, tash e disa vite, po zbaton edhe konceptin e miniparqeve, të cilat janë dëshmuar si zgjidhje të pëlqyeshme dhe tejet të nevojshme për komunitetin, kudo ku ato janë rregulluar deri më tani, për të vijuar edhe në vitin 2025 me rregullimin e disa prej tyre si në fshatin Prelez dhe Slivovë, si dhe mbjelljen e drunjve dekorativ, që vargun e shumëfishuar të investimeve në të gjelbërtën ta pasurojmë vazhdimisht.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, kemi përgatitur gjithashtu një tablo të projekteve të reja, me ndikim të drejtpërdrejt për zhvillimin e përgjithshëm të Ferizajt.

Vepra që ka marr përmasa identitare për Ferizajn, në gjithë vendin, nënkalimi për vetura dhe këmbësorë tek Stacioni Policor, do të vijoj me punën e pandalshme në hapjen e segmenteve të reja rrugore, për t'u përfunduar në tërësi si një vepër publike e transformimit të madh të Ferizajt, si një vlerë e shtuar e zhvillimit të hovshëm e të gjithanshëm të Ferizajt.

Punët transformuese infrastrukturore do të prekin edhe arteriet kryesore rrugore të qytetit si rikonstruktimi i rrugës “12 Qershori”, rrugëve “Besim Rexhepi” dhe “Rizah Matoshi”, rikonstruktimi i rrugës “Bedri Asllani” afër Nënkalimit të Ri, rikonstruktimi i rrugës dhe parkut tek Stacioni i Policisë në Ferizaj.

Po kështu, investimet do të orientohen edhe në vijimin e punëve në rikonstruktimin e rrugës “Tahir Sinani” ku tashmë veçse kemi filluar, për të kulmuar edhe me projektin e asfaltimit të rrugicave të qytetit, një projekt i rëndësisë së veçantë që e transformon në afatgjatë infrastrukturën rrugore të qytetit.

Projektet e rregullimit të infrastrukturës rrugore, do të shtrihen edhe në zona rurale, fshatrat e Ferizajt si projektet për asfaltimin e rrugëve në Zaskok, Mirash, Dremjak, Cërnillë, Surqinë, Rahovicë e Talinoc i Muhaxherëve.....

..... asfaltimi i rrugëve në fshatrat Varosh, Nikadin, Fshat i Vjetër, Gaçkë, Neredime, Balaj, Softaj, Koshare, Lloshkobare, Kosinë.....

.....po kështu edhe asfaltimi i rrugëve në Sojevë, Komogllavë, Bablak, Tërrn, Prelez i Jelive, Muhoc, Pleshinë, Doganaj si dhe rikonstruktimi i rrugës kryesore në Prelez të Jerlive, Varosh, Gaçkë, Rakaj e të tjera.

Në këtë pikëpamje, kemi paraparë edhe një mori investimesh në infrastrukturën nëntokësore, ujësjellës dhe kanalizim si dhe hapjen e puseve për një mori fshatrash.

Në këtë kuadër, projekte madhore për trajtimin e ujërave të zeza, e të cilat përfshihen në planet tona investive janë edhe Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza – për të cilën kemi arritur edhe dakordimin me BERZH-in si dhe projekti për ndërtimin e kolektorit nga Lagja e Qiraxhinjve në Nikadin deri në Gurëz.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Në planin e investimeve në shëndetësi dhe mirëqenie sociale, po kështu kemi disajnuar një varg projektesh, të fokusuara në ndërtimin e infrastrukturës shëndetësore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për pacientët.

Në këtë kuadër, tashmë ka përfunduar punimet e vrazhda, objekti i ri i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, bashkëfinancim me Ministrinë e Shëndetësisë e po njëjloj edhe objekti i ri i Qendrës së Mjekësisë Familjare nr.2 në rrugën “Remzi Hoxha”.

Këto ditë, përuruar qendrën moderne shëndetësore në Prelez të Muhaxherëve, andaj edhe me këto dy objekte moderne në përfundim e sipër, i japim zgjidhje afatgjate, nevojave për hapësira pune dhe shtrirje më të gjerë e cilësore të shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë edhe projeksionin tonë të buxhetuar tashmë, për ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Koshare.

Kundruar në këtë drejtim, me fokus në shërbimet shëndetësore, kemi paraparë investime edhe në blerjen e dy autoambulancave, 2 laboratorëve për nevoja të QMF-ve dhe autokllavin për nevoja të QKMF-së, si dhe blerjen e 10 karrigeve stomatologjike të cilat do të shpërndahen sipas nevojave dhe kërkesave në qendrat shëndetësore në qytet e fshatra.

Një nga segmentet e rëndësishme që paraqesin orientimin tonë investimor, është edhe arsimi, kultura, rinia dhe sporti.

Edhe në këtë sferë të rëndësishme të jetës shoqërore, kemi ndërtuar projeksionet tona të përfshira në këtë projekt buxhet, të cilat si të tilla, fokusin e vendosin në infrastrukturën shkollore dhe rritjen e cilësisë në arsim.

Përtej mbështetjes për studentë, ku vetëm këtë vit mbi 1000 studentëve i ndamë bursë nga Komuna, si në asnjë komunë të Kosovës e si asnjëherë më parë në historinë e arsimit të Ferizajt.....

.....projektet tona për ndërtimin e kapaciteteve të reja infrastrukturore, objekteve të reja shkollore janë fokus i qeverisjes sonë, siç është projekti për ndërtimin e shkollës së mesme në Ferizaj, ndërtimi i aneksit tek shkolla fillore “Gjon Serreqi”, ndërtimi i ankeseve të reja e renovimi dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese, duke përfshirë edhe sallat sportive shkollore.....

.....po kështu ndërtimi i objekteve të reja shkollore në fshatra si në Neredime, Manastirc, Tërrn, duke prioritzuar edhe një segment të rëndësishëm të punës arsimore, atë të investimit në rregullimin e kabineteve profesionale dhe pajisja me mjete laboratorike shkollore.

Në pikëpamje të infrastrukturës sportive, një vend të posaçëm zë projekti për Stadiumin e Ri të Futbollit “Ismet Shabani”, ku në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, është kryer tashmë studimi i fizibilitetit për këtë projekt në zonën rekreative-sportive, prapa Palestrës së Sporteve “Bill Clinton” dhe si Komunë, kemi marr përsipër të gjitha obligimet tona për ta jetësuar sa më parë, këtë projekt të mezi pritur nga të gjithë.

Kemi ideuar e buxhetuar projektin për renovimin e brendshëm të Palestrës “Bill Clinton”, ndërtimin e fushave sportive me taraflex, vijimin e projektit të ndërtimit të fushave sportive në qytet e fshatra, ndërtimi i fushave të futbollit të madh në Saraishtë, Sazli e Dardani si dhe ndërtimi i tribunave në stadiumin e qytetit si dhe në stadiumin “Tefik Çanga” në fshatin Tërrn.

Në pikëpamje të investimeve në fushën e artit dhe kulturës, në orientimin tonë investimor kemi po kështu ndërtimin e Obeliskut për Kuvendin e Ferizajt të vitit 1908, si dhe ndërtimin e veprave artistike skulpturale.

Në fushën e shërbimeve publike dhe emergjencë, do të vazhdojmë me përkushtim të bëjmë mirëmbajtjen e hapësirave publike, rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët, por edhe zbatimin e projekteve të reja në këtë fushë.

Kështu, kemi paraparë, ndërtimin e dy objekteve për nevoja të Komunës, zbatimin e projektit unik për vendosjen e monitorëve dinamik në trafik, rregullimin e udhëkryqeve rrugore duke i transformuar ato në degëzime të gjelbërta rrugore, rregullimi i vendndaljeve dhe pritoreve për autobusë.....

.....vazhdimin e projektit për rregullimin e infrastrukturës që mundëson qasjen e përsosur me aftësi të kufizuara në të gjitha akset rrugore, po kështu edhe projekti për ndërtimin e infrastrukturës për vendosjen e kontejnerëve mbitorësor dhe komposterëve, angazhimi ynë i vazhdueshëm për eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave nga hapësirat publike dhe rehabilitimi i këtyre zonave e po kështu është edhe projekti për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe kanaleve ujore.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Në planin e investimeve për bujqësinë, zhvillimin ekonomik dhe turizmin, kemi planifikuar një vistër projektesh. Përveç mbështetjes si asnjëherë më parë, me rreth 8 milionë euro subvencione për bujqit e fermerët përgjatë këtyre viteve, po kështu edhe me mbështetjen si asnjëherë më parë të grave ndërmarrëse dhe bizneseve tjera përmes Fondit për Mbështetje të Bizneseve.....

..... kemi ideuar e buxhetuar edhe projekte të veçanta si ndërtimi i Qendrës së Panairëve – Hipodromit, ndërtimi i silloseve për ruajtjen e grurit, hapja e kanaleve për kullimin e tokave bujqësore, rregullimi i kanaleve ujitëse në fshatrat Neredime dhe Balaj, si dhe hapja e rrugëve të arave me zhavor, investime këto që lehtësojnë, zhvillojnë e mbrojnë veprimtarinë bujqësore të bujqve e fermerëve ferizajas.

Në mesin e investimeve të fushave të ndryshme, një vend të rëndësishëm zënë edhe investimet në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit, të cilat synojnë të rrisin mundësitë e t'i qasen potencialit turistik të territorit tonë.

Në këtë kuptim, kemi ideuar edhe projektin për ndërtimin e infrastrukturës në zonën turistike në Neredime dhe Jezerc, po kështu zbatimi i projekteve të veçanta si rregullimi i infrastrukturës tek Ujëvara e Pleshinës, ndërtimi i Murit Alpin në Jezerc, rregullimi i infrastrukturës rreth Kalasë në Jezerc si dhe ndërtimi i shtigjeve të ecjes për personat e verbër në Neredime-Jezerc.

Edhe në fushën e administratës, pronës, kadastrit e gjeodezisë, do të vijojnë përpjekjet e nismat tona, për të modernizuar e digjitalizuar shërbimet, ashtu që të rritet cilësia, shpejtësia dhe qasja e qytetarëve në shërbimet komunale.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Ky projektbuxhet, ngërthen idetë e qytetarëve, kërkesat e tyre që derivojnë nga konsultimet publike, ngërthen vizionin tonë, analizën e vlerësimin e profesionistëve, që të vazhdojmë t'i japim Ferizajt, dimensione të reja zhvillimi duke hapur çdo ditë me punën tonë, shtigje të reja mundësish për të gjithë.....

..... andaj duke ju falënderuar për vëmendjen tuaj në këtë paraqitje të projekteve kapitale e planifikimit buxhetor për vitin 2025, jam besimplotë, se duke gjykuar nga përgjegjësia e

vendimmarrjes për interesin e qytetarëve, do t'i jepni vulën e miratimit, dokumentit themeltar, nga ku buron ecja përpara e Ferizajt, ritmi i pandalshëm i zhvillimit, 2025-ta e investimeve që meriton Ferizaj.

Ju faleminderit!

Kryesuesi pasi falënderoj Kryetarin e Komunës për paraqitjen e detajuar të projekt buxhetit theksoi se e hap debatin dhe ia kaloi fjalën:

BRAHIM OSMANI

Faleminderit i nderuari Kryesues;

Pjesëtarë të ekzekutivit;

Kolegë asamblastë;

Pjesëtarë të mediave e të shoqërisë civile;

Të nderuar qytetarë të Komunës sonë;

Sot, ndërsa diskutojmë buxhetin për vitin 2025, është me rëndësi që bashkë ta theksojmë rritjen e secilës kategori të buxhetit nga niveli qendror, që e dëshmon përkushtimin e Qeverisë të udhëhequr nga Kryeministri Kurti për mbështetjen e të gjithë qytetarëve të Ferizajt dhe tërë Kosovës.

Dihet që buxheti i Komunës sonë por edhe ai i përgjithshëm është rritur vazhdimisht falë menaxhimit të duhur në nivel qendror.

Vetëm për Vitin 2025, bashkë me të hyrat vetanake, afro 5 milionë euro më shumë janë alokuar për Ferizajn, duke e çuar buxhetin nga 41 milionë në mbi 46 milionë euro.

Kjo është fryt i qeverisjes që nuk i shmanget përgjegjësisë, që ka për qëllim të mirëqenien e qytetarëve dhe që vepron me ndershmëri, me transparencë dhe përkushtim të plotë për zhvillimin ekonomik e social të të gjithë vendit.

PDK-ja në pushtet nënkupton tragjedi për buxhetin dhe resurset. Buxheti, që në çdo vend normal duhet të jetë mjeti kryesor për përmirësimin e jetës së qytetarëve, këtu është bërë instrument për përfitime personale dhe shpërblime klienteliste e partiake.

Ky është buxhet përsëritës, ashtu edhe siç është vetë qeverisja. Pra përsëritëse, ngelçe siç thotë populli. Në këtë buxhet nuk janë sjellë ide të reja, nuk ka propozime për projekte vizionare që do t'i përmirësonin ndjeshëm kushtet e jetesës së qytetarëve të Ferizajt.

Në vend të ideve të reja, ne po shohim buxhet të strukturuar për të mbështetur interesat personale të një grushti njerëzish që janë të lidhur ngushtë me këtë pushtet. Dostat e Kryetarit për të qenë më korrekt.

Ky është buxhet që tregon se ky ekzekutiv e ka zgjedhur të rrisë edhe më shumë luksin e vet e të favorizojnë projektet që krijojnë hapësira për keqpërdorim. Ky nuk është buxhet për qytetarëve e

Ferizajt – por për rrethin e ngushtë të njerëzve që kanë shfrytëzuar çdo mundësi për të përfituar deri më tani dhe po duan të bëjnë edhe në vitin e fundit të qeverisjes.

Nepotizmi e klientelizmi janë dy sëmundjet kryesore të kësaj qeverisjeje. Nuk ka projekt të vetëm që të mos jetë i lidhur me përfitime për bizneset dhe individët që janë afër PDK-së. Tenderat shkojnë tek ata që janë të lidhur politikisht, dhe nuk ka asnjë garë të ndershme në shpërndarjen e fondeve publike.

Qytetarët kanë mbetur në mjerim infrastrukturor dhe projektet e premtuara, disa nga to të nisura para dy mandatesh e disa me gënjeshtër të panumërta janë dëshmi e dështimeve të protagonistëve të gënjeshtërve.

Parku te Stacioni i Autobusëve është premtim i fushatave të kaluara, dhe është kthyer në simbol të dështimit të PDK-së. Ky projekt, që do të duhej të përfundonte tashmë, nuk është as afër fillimit. Çfarë po prisni?

Parku te objekti i Pastërtisë është tjetër premtim që ka mbetur vetëm në letër dhe dëshmi e qartë e mungesës suaj të vullnetit për të realizuar projekte për qytetarët.

Shtëpia e Pensionistëve është me siguri një nga dështimet e mëdha të kësaj qeverisjeje. Një projekt që do të duhej të ishte prioritet absolut për një qeveri që pretendon se kujdeset për shtresat e shoqërisë, sidomos duke e ditur si i ka gënjyer në sy Kryetari kur ua pat rrënuar objektin e vjetër.

Pensionistët tanë, ata që kanë dhënë kontributin e tyre për këtë qytet, janë lënë pas dore. Ky është dështim i turpshëm dhe dëshmi se kjo qeverisje nuk ka ndjeshmëri as për të moshuarit, ashtu siç nuk ka për askënd tjetër, përpos për luksin që e fitoni nga taksat e qytetarëve.

Çerdhet janë edhe më keq. Po të njëjtat histori i kemi dëgjuar vit pas viti, deri tani. Çerdhet e premtuara janë zhdukur nga agjenda. Në vend që të ndërtohen çerdhe të reja, për t'u mundësuar fëmijëve tanë fillim arsimor e edukativ, ju po tentoni të privatizoni çerdhet aktuale, duke krijuar hapësirë të re për përfitime private në kurriz të fëmijëve e prindërve të tyre. Ky veprim është i papërgjegjshëm e qe besa edhe i rrezikshëm për të ardhmen e edukimit të hershëm në qytetin tonë.

Rregullimi i tregut të kafshëve dhe ndërtimi i strehimores së qenve janë po ashtu projekte të premtuara që nuk kanë parë asnjë zhvillim konkret. Si mund të pretendoni se jeni duke punuar për të mirën e qytetit, kur projekte të tilla themelore nuk janë as afër realizimit?

Tregu i gjelbër, që ka qenë në agjendën tuaj të premtimeve të rrejshme për një kohë të gjatë, është tjetër dështim. Ky treg është thelbësor për fermerët e tregtarët tonë, për të mbështetur ata që merren me këtë veprimtari dhe për të zhvilluar ekonominë vendore, por ju nuk keni bërë asnjë hap përpara në këtë drejtim.

Ky pushtet nuk ka më ide, nuk ka më vullnet, dhe nuk ka asgjë për të ofruar për qytetarët e Ferizajt.

Qytetarët e Ferizajt nuk kanë parë asnjë zhvillim gjatë mandatit tuaj dhe kjo për shkak se ju keni prioritet vetëm përfitimet tuaja personale.

Në vend që të zhvilloni projekte që u sjellin përfitime të drejtpërdrejta qytetarëve, ju keni mbështetur vetëm ata që ju mbështesin në rrugët tuaja të keqpërdorimi atë që e ka thënë edhe raporti i auditorit.

Qytetarët tanë meritojnë shumë më tepër. Ata meritojnë një qeveri që punon për ta e jo për veten e saj.

Ne, nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, do të qëndrojmë gjithmonë në anën e qytetarëve, për të mbështetur zhvillimin e tyre dhe për t'i mbrojtur interesat e tyre.

Ju faleminderit!

FLAMUR ISTREFI

Te nderuar te pranishëm,

Po diskutojmë sot, për një nga dokumentet me të rëndësishme që çdo vit e miraton ky kuvend, pra për buxhetin e vitit 2025 dhe për vlerësimet buxhetore për vitet 2026/2027

Ne pamje të parë, ky Projekt buxhet, të jep përshtypjen që në mënyrë indirekte mjaftueshëm do të ndikoj në përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët tanë, pasi që ka një rritje, ku nga 41 milion e 184 mijë Euro që ka qenë në vitin 2024, është rritur në 46 milion Euro, por që po të analizohet pak, del që pjesëmarrje me e lartë e këtij buxheti shkon në kategorinë ekonomike: Paga dhe mëdijtë me 45.45 % ose rreth 21 milion.

Pjesa tjetër e buxhetit shkon në Mallra dhe shërbime me 10 milion Euro, në shpenzime komunale 719 mijë euro, në Subvencione 2 milion e 50 mijë euro si dhe shpenzime Kapitale 12 milion e 328 mijë euro.

Në buxhetin e vitit të ardhshëm, vlen të theksohet se rritja me e vogël është të shpenzimet kapitale me vetëm 12.21%, kategori e cila realisht do duhej të kishte rritjen me të madhe, pasi që ndikon drejtpërdrejtë në lehtësimin e jetesës për qytetarët.

Tek kategoria mallra dhe shërbime, si edhe e vitet e kaluara, shpenzimet kryesore del që të jenë në mirëmbajtje dhe shpenzime për shërbime. Vetëm për mirëmbajtje shpenzohen 4 milion e 286 mijë euro, ndërsa për shërbime arrijnë në 3 milion e 351 mijë euro.

Për mua, është e çuditshme se si është e mundur që për mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore, nga 169 mijë euro sa ka qenë këtë vit, është rritur në 1 milion e 100 mijë euro për vitin e ardhshëm, ose kthyer në përqindje 548%. Pra, 930 mijë euro me shume, është ndryshimi brenda vitit për mirëmbajtjen e ndërtesave të njëjta arsimore. Këtë rritje, në këtë mënyrë, vetëm kjo qeverisje lokale di ta bëjë. E kuptoj që viti ardhshëm është vit zgjedhor, Po për mua rritja me 548 % për punën e njëjtë është e pakuptueshme.

Njëjtë është edhe me mirëmbajtje rutinore, ku nga 186 mijë euro sa ka qenë këtë vit, është rritur në 1 milion e 300 mijë, që i bëjnë 1 milion e 114 mijë euro me shume ose kthyer në përqindje, 598% me shume. Besoj që duhet ta kemi një sqarim të arsyeshëm në si kuvendar por edhe qytetarët se pse ka ndodhur kjo rritje kaq e lartë, e pa parë me herët në këto dy kode ekonomike.

Tek shpenzimet për shërbime: nga 2 milion e 679 mijë sa ka qene për kete vit, janë planifikuar 3 milion e 351 mijë euro prej te cilave vetëm për shërbime kontraktuese tjera janë ndare ; 2 milion e 147 mijë euro ose 343 mijë euro me shume se këtë vit. shërbime pra qe po rriten nga vit në vit.

Njëjtë është edhe me shërbime te veçanta/ ku behet fjale për Konsulent dhe kontraktor individual ku jane ndare 200 mijë euro, shume për te cilën do duhej te kishim informacion me te detajuar Se për çfarë behet fjale, për faktin se komuna ka mjaftueshëm ekspërt te fushave te ndryshme dhe kontraktimi i konsulentëve do te ishte i panevojshëm.

Investimet kapitale për vitin e ardhshëm, jane kryesisht investime te cilat qe nga fillimi i mandatit barten nga viti në vit e asnjëherë nuk përfundohen, e ku disa nga to janë:

Asfaltimi i rrugës “Gjergj Fishta” deri te rruga “Enver Topalli” dhe lidhja me rrugen “Ejup Statovci”

Ndërtimi i kompleksit te varrezat e qytetit

Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugës “Agim Ramadani” në zonën rekreative-sportive

Asfaltimi i rrugëve në Rahovice dhe Talinoc te Muhaxhereve

Rikonstruimi i rrugës “Besim Rexhepi” dhe “Rizah Matoshi”

Rregullimi i tregut te kafshëve dhe ndertimi i strehimores se qenve

Ndërtimi i QMF-Se ne Koshare

Rregullimi i tregut te gjelbërt

Ndërtimi i fushës për futboll Te madh në Sazli, Saraishte dhe Dardani etj

Pasi që Viti 2025 është edhe Viti i fundit i mandatit qeverisës lokal, projektet qe ishin premtuar në fushate por edhe gjate qeverisjes, një pjese e madhe e tyre nuk janë realizuar, pjesa tjetër nuk janë futur në buxhet për vitin e ardhshëm e disa qe Janë, janë vene për tri vitet e ardhshme gje Qe tregon qe vështirë Qe edhe mund Te fillojnë. Projektet kryesore qe nuk do të realizohen përfundimisht në këtë Mandat e për te cilin Kryetari Aliu ka trumbetuar me Se shumti, jane Projekte te gjelbërta që ai me Se shumti është thirrur,

pra kryetari Aliu ka dështuar te bej:

Parkun Te spitali, parkun Te shkolla “Gjon Serreçi” i cili ishte planifikuar te ishte me Park nëntokësor, lodra dhe hapësirë për te moshuarit,

ka dështuar lidhur me parku Te objekti i pastërtisë,

parku tek stacioni i autobusëve,

Ka dështuar te bej liqenin artificial,

ka dështuar te ndërtoj objektin e Komunës së re,

Ka dështuar në ndërtimin e fushave me bar Sintetik ne secilën Zone Te qytetit dhe në shumicën e fshatrave

Stadiumin e ri te qytetit Ismet Shabani

Ka dështuar ne projektin e tregut te kafsheve, Ka deshtuar Te ndertoj tregun e gjelbërt i cili ka qene i planifikuar te ndërtohet me hapësira të gjelbërta dhe kontejner nëntokësor

Funksionalizimi e çerdhes ne Greme ,

Ka dështuar te ndërtoj shtëpinë e pensionisteve te cilin ky vet i'a ka shkatërruar si dhe ndërtimin e shkollës së re ne Varosh

Përveç dështimeve ne realizimin e projekteve Qe vet kryetari i komunës i ka premtuar, kryetari Aliu duhet te dal e t'iu tregoj qytetareve Se një pjese e madhe e projekteve Qe I ka planifikuar ne buxhet për Vitin 2024 nuk do Te realizohen. Nuk do Te realizohen për faktin se për shkak te keq menaxhimit dhe keq planifikimit, edhe këtë vit por edhe vitin tjetër, përmbaruesit do Te marrin miliona euro nga buxheti i komunës si obligime Qe komuna ka ndaj personave fizik si dhe operatoreve ekonomik.

Një buxhet i cili nuk është gjithëpërfshirës dhe i cili nuk mund Te realizohet ne tersi për shkak te obligimeve te cilat kane ardhur si pasoje e keq menaxhimit dhe keq klasifikimit ne nuk mund ta votojmë.

Arian Imeri pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit theksoi se jemi mbledhur për të miratuar një dokument themeltar dhe besoj që edhe diskutimet projektet propozimet duhet të jen konkrete dhe korrekte, me thanë që qeveria e ka rrit buxhetin tregon për çfar nivelit të mashtruesve jemi tu folë, ujësjellësi u marrë si obligim i nivelit qendror dhe prap e diskutojnë si obligim të nivelit komunal ndonëse ne kemi parapa edhe shuma për këtë punë duhet ta kemi parasysh që buxheti aq sa është ka me mbet, ma shumë këta janë tu mirë se sa na kemi me i realizu projektet që i kemi premtua po nget që edhe këtyre atëherë ju ka pëlqy programi i kryetarit Aliu, të gjithë e dimë që kufit buxhetore destinohet nga niveli qendror, ekzekutivi ka mbajt diskutime takime dhe besoj që kjo është ma e mira e mundur prandaj edhe e përkrahi këtë buxhet.

Arbnora Salihu pasi përshëndeti të gjithë theksoi se si e thanë edhe parafolsit e mijë kjo seance është e rëndësishme pasi miratohet buxheti dhe nga kjo vlerë totale ku mbi 46 milion euro, këtu janë rritur dhe kjo flet se kjo më shumë është rritje e buxhetit nga thv, u fol kinse paska ba rritje qeveria, rekomandoj që të paktën fjalimet me i ndrru nga vitet e fundit edhe me dit qka po diskutojmë këtu edhe secili prej neve na takon me dalë me propozimet tona me projektet a janë përfshi diskutimet nga dëgjimet buxhetore.

Lumnije Morina pasi përshëndeti të pranishmit theksoi po pajtohemi që buxheti është një dokumenti më i rëndësishëm dhe si rrjedhoje e kësaj a është i mjaftueshëm ky buxhet në vlerë mbi 46 milion sigurisht që nuk është i mjaftueshëm për një komunë që është mbi 100 mij banorë, edhe kësaj here buxheti është hartu në atë mënyrë që ka rrjedhë në diskutim me qytetarë.

Prandaj duhet ta kenë mbështetjen tonë që të bëhet i realizueshëm.

Besim Haziri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se filimisht propozimi i Ismajlit të futet në buxhet pak edhe me Arbnoren pasi tha me i ndrru fjalimet unë po i them që duhet të rregullohen punët që rregullohet apo ndryshohen fjalimet i përmende parkut pse spo bëhet parku te stacioni pra po lirohet hapësira po spo bëhet parku pse.

Hatixhe Bungu Qerimi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se po vazhdoj me kërkun që ke kërkesë nga qytetarët që me hjek një investim kapital që është i një rendësi më të pakt edhe pse krejt janë të veçanta po pasi që kopshtet publike janë jetike duhet të ket fokus këtu.

Lulzim Abazi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se unë pa dasht me hy fellë në alizë të këtij dokumenti për vitin 2025 unë e kam analizu dhe kam vlerësuar që është i punuar në mënyrën më të mirë të mundshme është pak i çuditshëm që qdo gjë që vjen këtu flitet sikur është shumë i padobishëm ndërsa sa është i mirë këtë e kanë vlerësuar qytetarët dhe në kuadër të këtij besimi ai ka punua duke i përfunduar të gjitha premtimet.

Në pika të shkurta po du me tregu çka është projektbuxheti të cilët janë kundër këtij buxheti janë kundër pagave të shëndetësisë të mësimdhënësve këto si bëjmë ne kjo është qarkore që vijnë nga qeveria.

Ne mund të flasim te investimet kapitale mirëpo pikat tjera kur pikat tjera janë të pa prekshme dhe këto janë elemente bazë.

Kryesuesi pyeti nëse ka tjerë të interesuar për diskutim dhe pasi spati ia dha fjalën replikë Ibrahim Osmanit i cili theksoi se e para nuk jam vizitorë ti se ki problemin e pagave se me pas këtë problem si kishe qit çerdhet mi privatizua të hyrat vetanake krijohen nga tatimi në pronë dhe ju keni dal kundër kur na kemi ftu seancë të jashtëzakonshme, 10 vjet parcelen te spitali merri analizoj raportet e auditorëve keni ba pagesa pa projekt smuni me marrë projekt pa projekt pra cilat projekte i keni ba ska projekte.

Sylejman Metushi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi projekti te spitali është bërë në vitin 2008 ndërsa pse spitali s'bahet pyetni qeverisjen atje se projekti është nga viti 2008 mos shpifni ju faleminderit.

Xhavit Zariqi theksoi para se mja kalu fjalën kryetarit nuk mund pa e shpreh një shqetsim temin përsonal fatkeqësi për nivelin e komunës për debatin që bënë për të ardhem e vitit 2025 dmth është shqetësues mos mu diskutu as një propozim i vetëm se qka ka një projekt më të vogël kryetar e keni fjalën.

Kryesuesi pasi e hodhi në votim projektbuxhetin për vitin 2026-2027 kaloi me 23 vota për 9 kundër dhe O abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5 që është pika lidhur me dhënien në shfrytëzim të çerdheve dhe ia kaloi fjalën drejtorit Afrim Llabjanit i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se sot jemi këtu për të tretën herë për këtë pikë e di që keni materialin para vetës mirëpo do të përpiqem disa pika pse kemi nisur këtë propozim duke patur parasysh që në komunën tonë janë funksionale vetëm dy çerdhe dhe kemi të ndërtuara disa çerdhe dhe spo ka mundësi të funksionalizohen kemi menduar këtë formë si formë më të përshtatshme për ti funksionalizuar.

Sa i përket detajeve i keni në propozim mirëpo duhet të dini një gjë që nuk ka ditë që nuk vinë prindër nëna vetë ushqyese dhe gjithçka tjetër që kërkojnë zgjidhje për sistematizimin e fëmijëve në çerdhe.

Andaj kërkoj nga ju që edhe sot të ipen ide rekomandime se çka mund ta plotësojmë këtë dokument që të jetë i zbatueshëm në rrugëtimin tonë.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se drejtor nuk e di a na ke dëgjuar neve ne jemi për funksionalizimin sepse edhe ashtu ato që janë po demolohen ne kemi dhënë propozim që të subvencionohen e di që ka kosto mirëpo do të duhej që ashtu të bëhej.

Brahim Osmani theksoi që me mëngjes na ka ardhë një kërkesë nga punëtoret e çerdhes “Engjujt” dhe e lexoi atë letër (të cilën e kenë pasur të gjithë në asamble) Grupi i VV është parimisht kundër dhe në momentin që ka privatizim ka ngritje të çerdheve pastaj drejtori në bazë të kësaj marveshje do të funksionalizojmë çerdhen në fshatin greme ti marrëveshje ki moti me KARITAS-in pse su funksionalizuar sa kuzhinier i ki edhe të gjitha rregullohen pa patur nevojë mi privatizu ne edhe në fillim kërkuam që të hjeket kjo pikë.

Besim Haziri pasi përshëndeti të gjithë theksoi që unë mendoj që ska kuptim të bëhet privatizimi sikur të bëhet ndonjë kontrabandë minimumi do të duhej te bëhet një diskutim publik ne jemi këtu për të mirën e përgjithshme dhe kjo formë so e mirë e përgjithshme kujdes të gjithë do të keni përgjegjësi për këtë pikë pasi është në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve andaj minimumi duhet të shtyhet.

Shqipe Jashari i nderuar kryesues kryetar të gjithë të pranishëm ne pasi e përmendi edhe kryetari kërkojmë me ditë a ka pas kërkesë nga dka andaj bashkë me përgjigjen e ministrisë kërkojmë me na e sjellë kërkojmë me dit si kanë me u punësua këta punonjës jo vetëm mësimdhësit por të gjithë sa do të jenë pagat sa do të jen kontratat a kanë me i marrë pagat me kohë a kan me u kujdes për fëmijët e tan pasi kan mungesë të pagave, kemi parë që hjeket disa nga shpenzimet nga komuna dhe kjo është diskriminim për bizneset andaj unë jam kundër sa herë që preket e ardhjma e fëmijëve.

Hatixhe Bungu Qerimi pasi përshëndeti të gjithë dua mu ndërlidhë me fjalimin e kryetarit i cili na njëlllosi unë jam njëra nga ata që nuk e kam përkrah unë du me i than Kryetarit Aliu që ktu jam mi përfaqësu interesat e qytetareve dhe asnjëherë për kesi mendime madhore skam dhan mendim përsonal pasi këtu më kanë pru qytetarët dhe përfaqësoj ata kom prit që pe qitni ne diskutim publik dhe me marrë pjesë edhe përfaqësuesit e fushës me jep kontribut andaj i falenderoj që të gjithë, unë dua të bëjë të qartë që s’jam pro kësaj forme kështu të gjithë e dimë që çerdhet publike janë pasuri e përbashkët, unë do të ndalem të qdo pikë që keni qit në këtë dokument psh pika 3 drejtor qmimi për institucion është 100 euro a e ki fjalën për qira, nuk mund të caktohet fiks për secilin objekt nuk mund ti ipet qiraja si një objekt 200 metra katror si një 100 metra katrorë, pika e 6 thot afati i pronës deri në 15 vite është shumë qysh pi krijon zonë konforti për 15 vite ngase përfituesi nëse do me hjek dorë mund ta mbyllë njëkohësisht mund të ndryshoj edhe ligjet ministria dhe në këtë formë do të jemi në një situatë tepër të keqe, pasi tash po thoni skemi pare me investu në kopshte publike.

Te kriteret e vlerësimit pika 10 çmimi më i ulët si kriter qmimin e përcakton ekonomia e tregut në këtë rast nëse shkojmë me çmimin më të ulët këtu e pësojnë fëmijët, kriter tjetër 100 mijë euro për objekte a është fomru naj komision për me ba këtë vlerësim pasi kështu me shabllon s'banë me funksionu, pika 8 nëse unë se kam gjet ligjin në bazë të cilit ligj ja imponon që punëtorët aktual mi mbajt në punë pasi ai është privat i teket mja qit një përfermancë të keqe një puntori dhe e largon dhe a mundët më përcaktu shumën për fëmijë apo për disa fëmi me pas kritere si kanë qenë.

Këto janë pytjet që sot kërkoj përgjigje ju faleminderit.

Flamur Istrefi theksoi përpos asaj që tha Hatixhja desha të lidhëm me fjalimin e kryetarit aliu nuk nejti as 10 minuta për këtë temë kaq me interes të përgjithshëm këtu duhet të ka prioritete pasi ka nda mbi 300 mijë euro për mirëmbajtje dhe si ka nda 6000 mijë euro për punëtor, prandaj prioritet i kësaj qeverisje është mirëmbajtja, kërkoj që të del diskutim publik pastaj të vij faleminderit.

Arian Imeri është hera e tretë që po diskutojmë për këtë pikë pasi u thanë që problemi për çerdhe është një problem në nivel vendi edhe komuna Prishtinës e ka provu një zgjidhje ne e kemi propozu një opsion pasi s'kemi pas mundësi tjera mirë është që disa kolegë e diskutuan mirëpo këta e politizun këtë çështje cili do të ishte opsioni i tyre në funksionalizimin nëpër fshatra për shembull na po e shohim që spo mujm mi mirëmbajt mandej nuk jemi të sigurt se si do të shkoj kjo qështje ne po e provojmë një opsion pasi qëllimi ynë so me fitu prej kësaj çështje pasi këtu shihet që qëllim është mi funksionalizuar mi ruajt vendet e punës mirëpo besoj që këta po tutën që po funksionon kjo edhe këta dalin keq, prandaj operatori privat ka mi rujt vendet e punës mirëpo ne pe provojmë si opsion sa i përket procesit edhe opozita ka me qenë pjesë e procesit, ne sot pi aprovojmë kushtet e ankandit p.sh. unë propozoj të hiqet termi hjekja e tatimit diçka tjetër s'janë tu privatizua janë tu marrë me qira si mbas kushteve që ne i caktojmë si komunë, faleminderit.

Lumnije Morina pasi përshëndeti të pranishmit theksoi është hera tretë që po vjen kjo pikë unë jam e sigurt që komuna kur i ka ndërtua se ka mendu privatizimin mirëpo këto edhe pasi janë ndërtu jan jashtë funksionit pasi stafi që është i pranum nuk mund ti mbuloj të gjitha nevojat e objekteve pasi ska staf shtesë për këtë andaj komuna e ka pa të arsyeshme dhënien në shfrytëzim e cila so për 99 vjet po është për 15 vjet dhe normalisht nëse si përmban kushtet që i caktojmë ne i ndërprehen kontratat, unë mendoj që është vullnet i prindërve që të ketë çerdhe funskinale është më mirë me provu se me i lan ato në mëshirën e fatit dhe nëse me besën kështu ato bëhen strehë për qenë endacak e për përdorues të personave me narkotik unë mendoj që duhet të provohet, andaj kërkoj që të përmirësohet me kontribut nga secili nga ne p.sh. te qiraja mendoj që fillon nga 100 ndërsa vazhdon në ankand aq sa do të jetë aty. Pika 4 duhet të hjeket mendoj ashtu e mira e kësaj është që ofertuesi garanton për punëtor të çerdheve këta e siguron pika 8 sigurisht që ato bëhen në bazë të kushteve ligjore në pajtim me ligjin.

Lulzim Abazi pasi përshëndeti të gjithë si pikë e parë pi referona një dokumenti thotë propozim paraprak për dhënie në shfrytëzim të institucioneve absolutisht nuk ka ipet fjala privatizim ndërsa u dezinformu këtu fjala privatizim tingëllon ran dhe nënkupton diçka tjetër ndërsa në këtë rast janë tu dhanë në shfrytëzim për një kohë të caktuar.

Unë se di sa mun me kanë ma e madhe se fjala publike kur e jep kryetari me mbi 60 % kur thotë s'ka mju ra keq e kemi mendu ma mirë dhe këta brenda po dezinformojnë dhe besoj që realiteti është ajo që tha kryetari Aliu.

Ne jemi përballë me punonjësit e KARITAS-it ndërsa me këtë marrëveshje besoj që do të ketë pagë shumë ma dinitoze dhe kushte më të mira ata që janë kundër spo japin alternativë vetëm jan kundër sa për të prish plane, ndonëse në pyetje është funksionalizimi i çerdheve.

Këtu ka pas fjalë qe dihet kush e çka mirëpo nëse do tejet ashtu edhe unë do isha kundër po s'mund ti parashikojmë pasi do të jetë e hapur dhe do ta monitorojmë se bashku. Dhe lexoi kriteret aty duke theksua që ka mu ba komisioni dhe mi këqyr se a po ruhen këto kriteret qe ne pi vendosim.

Andaj pasi edhe kryetari dha fjalën publike ju ftoj që ta përkrahim se bashku këtë propozim ju faleminderit.

Mimoza Pajaziti pasi përshëndeti të gjithë unë s'dua të zgjas mendimin tim e dini jam pro hapjeve dhe jo mbylljeve dhe ku ka zhurmë ka gjallëri ka aktivitet gjithçka një pyetje drejtor kontrata prej 15 vite po më doket e tej zgjatur a mund të shkurtohet.

Ejup Delolli pasi përshëndeti të gjithë theksoi se krejt kto që u thanë disa patën drejt mirëpo te kërkesa kam një pyetje a është e drejt që një fëmijë në çerdhen private me pagu për dy fëmij 250 euro ndërsa dikush që po mundet mi shti ne çerdhe publike me pagu 100 euro afati është i gat mendoj që duhet mu shkurt mirëpo s'është e drejt dikush atje dikush atje me të hyra për afërt, të gjitha kriteret i ka ba komuna nëse na pëlqen i japim nëse sna pëlqen si japim mendoj qe duhet mu kry.

Hatixhe Bungu hiç s'kam qef mu shty me kolegë Lul, pot drejtona masi mu drejtove Lul, e kam lexu pasi në seancat e kalume janë kanë nja 7 rreshta ndërsa tash kokan nja 15 unë Flamur me dokument p.sh. shuma prej 100 mije euro kush e ka ba këtë studim ?

Flora Abdullahu pasi përshëndeti të gjithë unë pi falënderoj këto koleget për krejt mundin edhe sakrificën që keni bërë për edukimin e brezave drejtor cili ligj jau garanton këtyre kolegeve pagat e punën se u mundova me kuptu po spo mundem, a e keni bisedu me karitasin qka ka me ndodhë a jem tu desht me ruajt një interes të lartë të shoqërisë apo mi cenu këto vlera pse mos me ardhë me rregulla të qarta jam shumë me emocion më falni.

Arbnora Salihu e pash të arsyeshme me marrë edhe unë fjalën pasi jam kanë në diskutim me qytetarë po besoj qe kemi me marrë përgjigje prej drejtorit p.sh. pse është me patjetër me kalu në këtë seanc a kishim mujt me organizua një diskutim publik dhe me i marrë të gjitha kërkesa e personave të kësaj fushe mirëpo kish mujt me u kompletua ende, ju faleminderit.

Lulzim Abazi qëllimi i daljes sime është se pata me kolegen time direkt mos e ndi veten aty ski nevojë me mu drejtu ashtu në lidhje me diskutimin është met ardhë keq flora me dal këtu edhe dy fjalë mos me dit mi lidh më vjen keq.

Xhavit Zariqi dua ti them dy fjalë edhe unë jem tu diskutua një çështje tepër te ndishme dhe komplekse dhe so let me marr vendim as nuk qendron që është propozimi ma i mirë dhe as nuk qëndron ajo që ato mund të funksionalizohen pasi është një gjendje e tillë komplekse dhe prap pe

them që so zgjidhja ma e mirë drejtor propozimet që keni ba sjan shumë të karta pse psh i lypen 600 mijë euro cila arsyeja a është paraprakisht se kush i ka pasi është e vështirë kjo për disa biznese të mase që merren me këto çështje, nën 2 a ka kriter që ai që duhet të aplikoj të jetë i licencum pastaj pse duhet edhe mja dhanë hapësirën shfrytëzim dhe me ja pagu krejt këto e 3 a do të ketë subvencionim për fëmijët që shkojnë në çerdhe dhe nëse do të ketë unë jam kundër nëse do të ketë vetëm për fëmijët që vetëm ne i japim në shfrytëzim kërkoj përgjigje nga këto.

Ibrahim Hyseni pasi përshëndeti të gjithë theksoi se unë pajtohem me diskutimin e kryetarit aj përson që i merr në shfrytëzim këto lokale sigurisht i merr me përfitu këta duhet ta kem parasysh sa i përket garancionit të pagave mirëpo bashkëpunëtorët qohen në grevë që ata paguhen ma pak se paga minimale p.sh. Kuvendi i Kosovës.

E vetmja formë që me funksionalizuar është që të merr subvencion na po dojmë me ba balancim të çmimeve mirëpo ai që investon 600 mijë euro dhe me të gjitha këto rëndesa p.sh. rritja e pagave kjo vetëm nëse e merr komuna me subvencionua se s'besoj që funksionon.

Këto kritere që i lexuam deri tash as unë si kam shume të karta edhe unë kërkoj njëjt si kryesuesi që të bëhet një grup punues që ti menagjojë këto kritere ju faleminderit.

Arian Imeri theksoi si duket na spo besojmë në institucionin e ankandit ne duhet të besojmë në ato pasi ajo është forma ma e përshtatshme për me u dhanë në shfrytëzim pasi ato kushte janë bazike s'mundet askush me ju ikë p.sh. një prej kushteve është që me i mbajt punëtorët dhe nëse si mban normalisht shkelen kriteret dhe kushdo që ka opsione net propozon kriteret që të bëhet më i mirë ky ankand edhe unë pajtohet që të bëhet 5 vite, problemi i rritjes se punëtove publik edhe ne qeveritë tjera u kanë ky problem so veç ne këtë qeveri prandaj po propozojmë me hjek pika 4 d.m.th. mos të hjeket asnjë dhe afati nga 15 vite të bëhet në 5 vite te garancioni s'jemi me dhanë diku që s'ka qysh e mban që e ka veç me provu.

Edhe një pyetje a duhet t'i marrë konkurruesi të gjitha çerdhet apo mund ti marrë të gjitha dhe këtë duhet ta definojmë pasi mund të ketë interes ta merr në qytet ndërsa jo në fshat.

Edhe drejtori u pajtua që të jetë p.sh. pika 7 të hjeket të gjitha lehtësirat, licencim duhet të ketë afati nga 15 vjet duhet të bëhet në 5 si dhe ofertuesi duhet të aplikoj për të gjitha çerdhet.

Me këto kritere të ndryshuara hidhet në votim dhe kaloi me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenime.

Pas miratimit të kësaj pike kuvendi doli në pauzë 30 minuteshe

Kryesuesi e lexoi piken e 6 dhe u hodh në votim kaloi me 22 vota për 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi piken e 7 dhe u hodh në votim kaloi me 21 vota për 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi piken e 8 dhe pasi spati të interesuar për diskutim kaloi me 20 vota për 0 kundër 2 abstenim, më pas kryesuesi e lexoi pikën e 9 dhe pasi spati të interesuar për diskutim kaloi me 21 vota për 0 kundër 0 abstenim. Kryesuesi e lexoi pikën e 10 dhe pasi spati të interesuar për diskutim kaloi me 22 vota për 0 kundër 0 abstenim, Kryesuesi e lexoi piken e 11 dhe drejtori i lexoi kriteret e ankandeve për dhënien e lokaleve të stacionit nëse ka dikush diçka urdhëroni dhe pasi spati kaloi me 21 vota për 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 12 dhe pasi spati të interesuar për diskutim u hodh në votim dhe kaloi me 22 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 13 dhe pyeti nëse ka të interesuar për diskutim dhe pasi spati kaloi me 21 vota për 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi piken e 14 dhe pyeti nëse ka te interesuar për diskutim dhe pasi spati edhe kjo pikë kaloi me 22 vota për 0 kundër 0 abstenim.

Piken e 15 e ia dha fjalën Sabri Murslelit i cili i paraqiti plotësimet që kam bërë edhe në KPF dhe për këtë kemi pranë një kërkesë për qasje të parcelave të lartcekura dhe nuk është për këmbim është veç për vlerësim ju faleminderit.

Ejup Delolli në bazë të deklaratës së palës pra pala ka kërku që të procedohet edhe sipas kërkesë së palës që e keni në dosje, DREJTOR pyeti Kryesuesi a ka mundësi me fut edhe këtë drejtori u përgjegg që mundet dhe u hodhë në votim ashtu me ndryshimin që propozoj Ejupi dhe kaloi me 21 vota për 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 16 për caktimin e nevoja për banorët e fshatit Komogllavë dhe pasi spati të interesuar për diskutim u hodh në votim dhe kaloi me 21 vota për 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 17 shfuqizimi i planit të integritet dhe tregoi që ka ndyrshu rregullorja dhe është e domosdoshme dhe e hodhi në votim kaloi me 21 vota për 0 kundër 0 abstenim.

Kryesuesi pyetje kërkesa kush ka: Sadat Ismajli pasi përshëndeti të gjithë theksoi se është një ankesë në rrugën Isemt Jashari policia ka ndërmarr aksione aty kshtu që kërkojmë me dal inspektorët e punës pasi ka dyshime për zhvillim të gjanave të këqija.

Hyzri Kamencia parqiti problemin e mosfunksionimin e QMF në fshatin Mirash dhe kërkoj që së paku një herë në javë të ketë punonjës aty pasi ka kërkesë të vazhdueshme nga qytetarët.

Kryesuesi - Në të ndryshme a ka dikush diçka, pasi nuk unë e shpalli të mbyllur këtë mbledhje ju faleminderit.

Procesmbajtësi



Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi